

## KIRFN Interpretimi 20

### ***Kostot e Pastrimit (Largimit) në Fazën e Prodhimit të një Miniere Sipërfaqësore***

#### **Referenca**

---

- *Kuadri Konceptual për Raportimin Financiar*
- *SNK 1 Paraqitja e Pasqyrave Financiare*
- *SNK 2 Inventarët*
- *SNK 16 Aktivitet Afatgjatë Materiale*
- *SNK 38 Aktivitet Jo-Materiale*

#### **Informacion Bazë**

---

- 1 Gjatë aktivitetit të minierave sipërfaqësore, njësitë ekonomike mund të kenë të nevojshme largimin e mbeturinave materiale ('mbingarkesa') për të mundësuar depozitimin e mineraleve. Ky aktivitet i heqjes së mbeturinave njihet si 'largim'.
- 2 Gjatë fazës së zhvillimit të minierës (para se të fillojë prodhimi), kostot e largimit zakonisht kapitalizohen si pjesë e kostos së amortizueshme të krijimit, zhvillimit dhe ndërtimit të minierës. Këto kosto të kapitalizuara amortizohen mbi baza sistematike pasi fillon prodhimi, zakonisht duke përdorur metodën e njërive të prodhuara.
- 3 Njësia ekonomike që shfrytëzon një minierë mund të vazhdojë të largojë mbingarkesa dhe të ndeshë kosto largimi gjatë fazës së prodhimit të minierës.
- 4 Materialet 'mbingarkesë' të larguara gjatë fazës së prodhimit mund të mos jenë 100 për qind mbeturina; shpesh mund të jenë një përzierje e mineralit me mbeturinat. Përqindja e mineralit kundrejt mbeturinave mund të variojë nga një nivel i ulët jo ekonomik në një nivel të lartë fitimprurës. Largimi i materialeve me një përqindje të ulët minerali mund të krijojë material të përdorshëm, i cili mund të përdoret për të krijuar inventar. Ky largim mund të të sjellë edhe shfrytëzimin e niveleve më të larta të materialeve që kanë një përqindje të lartë minerali kundrejt mbeturinave. Pra njësia ekonomike mund të ketë dy përfitime nga aktiviteti i largimit: mineral të përdorshëm për të krijuar inventar dhe përmirësimi i shfrytëzimit të sasive të tjera të materialit që do të nxirren nga miniera në periudhat e ardhshme.
- 5 Ky Interpretim merr në konsideratë se kur dhe si duhet të trajtohen, veçmas këto dy përfitime nga aktiviteti i largimit, si dhe se si duhen matur fillimisht dhe më pas këto përfitime.

#### **Objekti**

---

- 6 Ky Interpretim zbatohet për kostot e largimit të mbeturinave që ndeshen në aktivitetin e minierave sipërfaqësore gjatë fazës së prodhimit ('kosto të largimit të prodhimit').

#### **Çështje**

---

- 7 Ky Interpretim trajton çështjet në vijim:
  - (a) njohja e kostove të largimit të prodhimit si një aktiv;
  - (b) matja fillestare e aktivitetit nga aktiviteti i largimit; dhe
  - (c) matja e mëpasshme e aktivitetit nga aktiviteti i largimit.

**Konsensusi****Njohja e kostove të largimit të prodhimit si një aktiv**

- 8 Njësia ekonomike do të trajtojë kostot e aktivitetit të largimit në përputhje me parimet e SNK 2 *Inventarët deri në masën* që përfitimet nga aktiviteti i largimit realizohen në formën e inventarit të prodhuar. Deri në masën që përfitimi është akses i përmirësuar për mineralin, entiteti do t'i njohë këto kosto si një aktiv afatgjatë, nëse plotësohen kriteret e paragrafit 9 më poshtë. Ky Interpretim i referohet aktivitetit afatgjatë si 'aktiv nga aktiviteti i largimit'.
- 9 Një njësi ekonomike duhet të njohë një aktiv nga aktiviteti i largimit, vetëm dhe vetëm nëse plotësohen kushtet në vijim:
- është e mundur që përfitimet ekonomike në të ardhmen (përmirësimi i shfrytëzimit të minierës) që i atribuohen aktivitetit të largimit, do të rrjedhin tek njësia ekonomike;
  - njësia ekonomike mund të identifikojë përbërësin e minierës, të cilit i është përmirësuar shfrytëzimi; dhe
  - kostot e aktivitetit të largimit që i takojnë atij përbërësi mund të maten në mënyrë të besueshme.
- 10 Aktivi nga aktiviteti i largimit do të trajtohet si shtesë ose si një zgjerim i një aktivi ekzistues. Me fjalë të tjera, aktivi nga aktiviteti i largimit do të trajtohet si pjesë e një aktivi ekzistues.
- 11 Klasifikimi i aktivitetit nga aktiviteti i largimit si aktiv material ose jo material është i njëjtë me aktivet ekzistuese. Me fjalë të tjera, natyra e aktivitetit ekzistues do të përcaktohet nëse njësia ekonomike do të klasifikojë aktivin nga aktiviteti i largimit si aktiv material ose jo-material.

**Matja fillestare e aktivitetit nga aktiviteti i largimit**

- 12 Njësia ekonomike do të matë aktivin nga aktiviteti i largimit fillimisht me kosto, e cila përmbledh kostot direkte të ndeshura për kryerjen e aktivitetit të largimit që përmirëson shfrytëzimin e përbërësit të identifikuar të mineralit, plus një pjesë të shpenzimeve të tjera të përgjithshme direkte. Gjatë aktivitetit të largimit të prodhimit mund të ndodhin dhe aktivitete të tjera rastësore të cilat nuk janë të domosdoshme për vijueshmërinë sipas planit të aktivitetit të largimit të prodhimit. Kostot që lidhen me këto aktivitete rastësore nuk duhet të përfshihen në koston e aktivitetit nga aktiviteti i largimit.
- 13 Nëse kostot e aktivitetit nga aktiviteti i largimit dhe të inventarit të prodhuar nuk mund të identifikohen veçmas, njësia ekonomike duhet të shpërndajë kostot e largimit të prodhimit mes inventarit të prodhuar dhe aktivitetit nga aktiviteti i largimit mbi një shpërndarje të bazuar në një matës të rëndësishëm të prodhimit. Ky matës i prodhimit duhet të llogaritet për përbërësin e identifikuar të minierës dhe duhet të përdoret si standard vlerësimi për të identifikuar madhësinë e aktiviteteve shtesë që krijojnë përfitime të ardhshme. Shembuj të matësve të tillë përfshijnë:
- kosto e inventarit të prodhuar krahasuar me koston e pritshme;
  - vëllimi i mbeturinave të nxjerra krahasuar me vëllimin e pritshëm, për një vëllim të dhënë të prodhimit mineral; dhe
  - përmbajtja e mineralit të nxjerrë krahasuar me përmbajtjen e pritshme të mineralit për t'u nxjerrë, për një sasi të dhënë të mineralit të prodhuar.

**Matja e mëpasshme e aktivitetit nga aktiviteti i largimit**

- 14 Pas njohjes fillestare, aktivi nga aktiviteti i largimit do të mbartet me koston e tij ose vlerën e rivlerësuar minus zhvlerësimin ose amortizimin dhe çdo humbje nga zhvlerësimi, njëllon si aktivi ekzistues tek i cili bën pjesë.
- 15 Aktivi nga aktiviteti i largimit do të zhvlerësohet ose amortizohet mbi baza sistematike, përgjatë jetës së dobishme të pritshme të përbërësit të identifikuar të minierës, shfrytëzimi i të cilit përmirësohet si pasojë e aktivitetit të largimit. Do të përdoret metoda e njësive të prodhura me përjashtim të rastit kur një tjetër metodë është më përshtatshme.
- 16 Jeta e dobishme e pritshme e përbërësit të identifikuar të minierës që përdoret për zhvlerësimin ose amortizimin e aktivitetit nga aktiviteti i largimit do të ndryshojë nga jeta e dobishme e pritshme që përdoret për zhvlerësimin ose amortizimin e minierës dhe të aktiveve të tjera që lidhen me jetën e saj. Bëjnë përjashtim situatat e rralla në të cilat aktiviteti i largimit sjell përmirësimin e shfrytëzimit të minierës në tërësi. Për shembull kjo mund të ndodhë në fund të jetës së dobishme të minierës kur përbërësi i identifikuar përfaqëson pjesën e fundit të mineralit për t'u nxjerrë nga miniera.

## Shtojca A

### Data e hyrjes në fuqi dhe dispozitat kalimtare

*Kjo shtojcë është pjesë e pandarë e këtij Interpretimi dhe ka të njëjtin autoritet si pjesët e tjera të Interpretimit.*

- A1 Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këtë Interpretim për periudhat vjetore që fillojnë më datën 1 Janar 2013 ose më pas. Lejohet zbatimi para kësaj date. Nëse një njësi ekonomike e zbaton këtë Interpretim për një periudhë më të hershme, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.
- A2 Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këtë Interpretim për kostot e largimit të prodhimit të ndodhura në datën fillimit ose më pas të periudhës më të hershme të paraqitur.
- A3 Në fillim të periudhës më të hershme të paraqitur, çdo tepricë e njohur më pare e aktivitet që vjen nga aktivitetet e largimit të ndërmarra gjatë fazës së prodhimit ('aktiv i larguar në periudhën e mëparëshme') duhet të riklasifikohet si pjesë një aktivi ekzistues të lidhur me aktivitetin e largimit në madhësinë që përbërësi i identifikueshëm i mbetur i minierës lidhet me aktivin e larguar në periudhën e mëparëshme. Këto teprica duhet të zhvlerësohen ose amortizohen përgjatë jetës së dobishme të pritshme të përbërësit të identifikuar të minierës me të cilin ato lidhen.
- A4 Nëse nuk ekziston një përbërës i identifikueshëm i minierës me të cilin lidhet aktivi i larguar në periudhën e mëparëshme, ai do të njihet në çeljen e fitimit të pashpërndarë në fillim të periudhës më të hershme të paraqitur.

## Shtojca B

Ndryshimet në këtë shtojcë duhet të zbatohen për periudha vjetore që fillojnë më 1 Janar 2013 ose më pas. Nëse një njësi ekonomike zbaton këtë Interpretim për një periudhë më të hershme, këto ndryshime duhet të zbatohen edhe për atë periudhë.

### Ndryshime në SNRF 1 *Adoptimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për Herë të Parë*

B1 Në Shtojcën D, paragrafi D1 është ndryshuar si vijon (teksti i ri është nënvizuar dhe teksti i fshirë është shënuar me vijë në mes):

D1 Një njësi ekonomike mund të zgjedhë të përdorë një ose më shumë nga përjashtimet e mëposhtme:

(a) transaksionet e pagesave të bazuara në aksione (paragrafët D2 dhe D3);

...

(m) aktivet financiare ose aktivet jo-materiale të trajtuara në përputhje me KIRFN 12 *Marrëveshjet Konkensionare të Shërbimit* (paragrafi D22);

(n) kostot e huamarrjes (paragrafi D23);

(o) transferimi i aktiveve nga klientët (paragrafi D24);

(p) shlyerja e pasiveve financiare me instrumenta të kapitalit të vet (paragrafi D25);

(q) hiperinflacioni i lartë (paragrafët D26–D30); ~~dhe~~

(r) marrëveshjet e përbashkëta (paragrafi D31); dhe

(s) kostot e largimit në fazën prodhimit të një miniere sipërfaqësore (paragrafi D32).

B2 Pas paragrafit D31 është shtuar një titull dhe paragrafi D32:

#### **Kostot e largimit në fazën e prodhimit të një miniere sipërfaqësore**

D32 Një zbatues për herë të parë mund të përdorë dispozitat kalimtare të paraqitura në paragrafët A1 deri në A4 të KIRFN 20 *Kostot e Largimit në Fazën e Prodhimit të një Miniere Sipërfaqësore*. Në këtë paragraf, si datë referencë e hyrjes në fuqi duhet të interpretohet 1 Janar 2013 ose fillimi i periudhës së parë të raportimit sipas SNRF-ve, cila të jetë më e vonshme mes të dyjave.

B3 Pas paragrafit 39L është shtuar paragrafi 39M:

39M KIRFN 20 *Kostot e Largimit në Fazën e Prodhimit të një Miniere Sipërfaqësore* shtoi paragrafin D32 dhe ndryshoi paragrafin D. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këtë ndryshim kur zbaton KIRFN 20.